



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Kuvendi i Komunës Rahovec  
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Orahovac  
ORAHOVAC



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br./str./No.pg 93

Data/Datum/Data 30.05.2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1.1 lidhur me nenin 4 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 52/2009"), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2023 merr këtë:

### V E N D I M

#### Për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. Prot. 02/577/23 i datës 1.5.2023 dhe i jepet **pëlqimi** për të iniciuar procedurën për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për interes të përgjithshëm publik për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe konservimin e shtëpisë – shtabit të UÇK-së në zonën e Mrasorit.
2. Shpronësimi sipas pikës 1 të këtij vendimi ka të bëjë me paluajtshmërinë private sipas certifikatës së pronësisë P-71510052-00369-0, në emër të Sokol (Rexh) Rexhepi, me sipërfaqe prej 240m<sup>2</sup> (dyqind e dyzet metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10610m<sup>2</sup> (dhjetë mijë e gjashtëqind e dhjetë metra katror).
3. Vërtetohet se ruajtja, mirëmbajtja dhe konservimi i shtëpisë – shtabit të UÇK-së në zonën e Mrasorit është qëllim i ligjshëm dhe në interes të përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluajtshmërisë së lartcekur është në shërbim të këtij qëllimi.
4. Pronari i pjesës së ngastrës kadastrale të cekur ne pikën 2 të këtij vendimi do të kompensohet konform dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205.
5. Obligohet Kryetari i Komunës që konform ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për shpronësimin e pronës së paluajtshme private të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
6. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.83/23**  
**Me datë:30.05.2023**

